

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

KM-MIT-01

Nr. i Prot. 315 /19
 Br. Prot. 315 /19
 Data: 13.05.19
 Datum: 13.05.19
 Date: 13.05.19

2

PRISHTINË/A



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nëna Org. 01
 Org. Jeshkica
 Org. Uhe 01
 Nr. i Faqeve 2
 Br. Stranica
 No. Pages 2

Nr. i Prot. 4975
 Broj Prot. 4975
 Prot. No. 4975
 Data: 13.05.19
 Datum: 13.05.19
 Date: 13.05.19

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa nr.1891 datë 26.02.2019 parashtruar nga Shoqata e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Kosova e Lirë" me seli në Prizren dhe Shoqata e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Theranda" me seli në Suharekë, kundër vendimit nr.1643 të datës 21.02.2019 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjeve si tërësi në relacionin Prizren - Sllatinë - Prishtinë (nisje expres nëpër autostradë) dhe ansjelltas.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.2259 datë 06.03.2019 pas shqyrtimit të ankesës, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndërrurbane nisjet e shpallura në relacionin Prizren-Sllatinë-Prishtinë nëpër autoudhë nuk pengojnë në nisjet aktuale të lëshuara nga MIT-ja në relacionin aktual përgjatë magjistrales Prizren - Suharekë - Shtime - Prishtinë pasi që kjo është një trase e re.

Vlenë të theksohet fakti se kemi pasë kërkesa të shumta të qytetarëve për të pasur linja nëpër autoudhë për faktin e shfrytëzimit të infrastrukturës rrugore e cila ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të transportit për udhëtarët përkatësisht komoditet dhe arritje më të shpejtë në kryeqytet, poashtu kjo domosdo ndikon edhe në koston financiare të shërbimeve si për pasagjerët një ashtu edhe për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve.

Gjithashtu duhet të kemi parasysh investimet e shumta që janë bërë në ndërtimin e infrastrukturës rrugore përkatësisht autoudhës e cila patjetër që duhet të shfrytëzohet në këtë kontekst, edhe shfrytëzimin e saj për bartjen e udhëtarëve në relacionet që përshkon autoudha gjegjësisht relacioni Prizren - Prishtinë dhe anasjelltas.

Në rastin konkret ka vlerësuar se është në interes të qytetarëve për të krijuar kushte sa më të favorshme në të mirë të ofrimit të shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus të cilët në shumicën e rasteve për shkak të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë në relacionin e lartëcekur nga magjistrallja Prishtinë - Prizren janë të obliguar që të qëndrojnë në këmbë për gjatë tërë udhëtimit.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrorjë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

